

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE – NDRYSHIM I KUSHTEVE TË LEJES SË TIPIT A – PN-0874-12-2021

MARS 2026

BREMA AMBIENTE SHPK
PËRFAQËSUES I SUBJEKTIT: AV. SELIM BREGU
POZICIONI: ADMINISTRATOR

PËRGATITI RAPORTIN: KLEVIS BREGU
EKSPERT MJEDISI ; CERTIFIKATA NR IDENTIFIKUES 611



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE.....	2
2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT.....	10
3. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE QËLLIMI.....	12
4. PROCESI TEKNOLOGJIK - PROCEDURAT PËR MARRJEN NË DORËZIM DHE PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE.....	13
5. MENAXHIMI I INSTALIMIT.....	37
6. NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS.....	38
7. MASAT KRYESORE LEHTËSUESE.....	41
8. MONITORIMI I PLANIFIKUAR.....	42

BREMA AMBIENTE SHPK

1. HYRJJE

Ky dokument përbën përmbledhjen joteknike të aplikimit për ndryshim të kushteve të Lejes Mjedisore të subjektit Brema Ambiente Sh.p.k, leje mjedisore e tipit A me numër: PN-0874-12-2021, e përgatitur për qëllime informimi dhe konsultimi me publikun. Ndryshimi i kërkuar konsiston vetëm në shtimin e disa kodeve të reja të mbetjeve për trajtim, në përputhje me legjislacionin kombëtar për menaxhimin e mbetjeve dhe me kapacitetet ekzistuese teknike të operatorit.

Në këtë ndryshim të kushteve:

- Nuk parashikohen ndryshime në teknologjinë e trajtimit.
- Nuk do të ketë rritje të kapaciteteve të instaluar.
- Nuk parashikohet zgjerim i sipërfaqes së aktivitetit.
- Nuk ka ndryshime në infrastrukturën ekzistuese.
- Nuk ka ndikime të reja apo shtesë në mjedis krahasuar me situatën aktuale.

Ky aplikim ka karakter administrativ dhe funksional, me qëllim optimizimin e spektrit të mbetjeve që mund të trajtohen brenda të njëjtës skemë operimi. Brema Ambiente Shpk është një operator i licencuar në fushën e menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve, i cili ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve. Aktiviteti zhvillohet mbi bazën e një Leje Mjedisore të miratuar nga autoriteti kompetent, duke respektuar të gjitha kushtet teknike, mjedisore dhe të sigurisë të përcaktuara në të.

Subjekti zbaton procedura të kontrolluara për:

- Pranimin dhe verifikimin e mbetjeve.
- Trajtimin sipas metodave të miratuara.
- Dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e plotë të flukseve të mbetjeve.

Ndryshimi i propozuar konsiston në:

- Shtimin e disa kodeve të reja të mbetjeve në listën e mbetjeve të autorizuara për trajtim.
- Këto kode i përkasin kategorive të ngjashme teknike dhe metodat e trajtimit mbeten të pandryshuara. Pajisjet dhe infrastruktura ekzistuese janë të njëjtat. Procedurat operative dhe masat e sigurisë mbeten identike. Nuk ndryshon natyra e aktivitetit.

Pra, shtimi i kodeve të reja nuk përbën zgjerim aktiviteti në kuptimin teknik apo mjedisor, por një harmonizim dhe përditësim të spektrit të mbetjeve të lejuara, në përputhje me kërkesat e tregut dhe nevojat për menaxhim më efikas të mbetjeve në nivel kombëtar.

Bazuar në analizën paraprake:

Nuk pritet rritje e emetimeve në ajër.

- Nuk pritet ndryshim në shkarkimet në ujë.
- Nuk pritet rritje e nivelit të zhurmës.
- Nuk pritet ndryshim në gjenerimin e mbetjeve dytësore.
- Nuk pritet ndikim shtesë në tokë apo në shëndetin e komunitetit përreth.

Të gjitha operacionet do të vazhdojnë të kryhen brenda standardeve të përcaktuara nga legjislacioni mjedisor dhe kushtet e lejes ekzistuese.

Masat aktuale të kontrollit përfshijnë:

- Sipërfaqe të betonizuara dhe të papërshkueshme.
- Menaxhim të ujërave të ndotura sipas kushteve të lejes.
- Monitorim periodik i elementeve ajër, ujë, tokë.
- Përdorim të pajisjeve mbrojtëse personale,
- Trajnim të vazhdueshëm të stafit.

Shtimi i kodeve të reja të mbetjeve synon rritjen e fleksibilitetit operacional të subjektit,

ofrimin e një shërbimi më të plotë për gjeneruesit e mbetjeve, përmirësimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve në përputhje me parimin e ekonomisë qarkulluese.

Ndryshimi i kërkuar do të shqyrtohet nga autoriteti kompetent, i cili do të vlerësojë përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi.

Në kuadër të transparencës dhe përfshirjes së komunitetit, ky dokument paraqitet për konsultim publik.

Duke qenë se ndryshimi nuk përfshin rritje kapaciteti, ndryshim teknologjie apo ndikime të reja mjedisore, nuk parashikohet ndryshim në situatën aktuale të mjedisit për zonën përreth.

SHOQËRIA "BREMA AMBIENTE" SHPK DHE VEPRIMTARIA E SAJ

Shoqëria "BREMA AMBIENTE" Shpk është një shoqëri koncesionare e regjistruar të realizojë aktivitetin e saj brenda territorit shqiptar e cila e ka filluar aktivitetin e saj ekonomik që në vitin 2012.

Referuar edhe ekstraktit të saj të regjistrimit, objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ai i përcaktuar ekskluzivisht me Marrëveshjen e Koncesionit datë 17.10.2012, nr. 3317 Rep. nr. 1305 Kol. Si shoqëri e krijuar për qëllime të vecanta (SPV), veprimtaria e saj është ngushtësisht projektimi, ndërtimi, testimi autorizimi, zhvillimi, operimi i projektit koncesionar, si fillim, e në vijim edhe kryerjen e aktivitetit industrial në emër të vet në përputhje me projektin koncesionar dhe kontratën e koncesionit.

Me fillimin e veprimtarisë së plotë të saj, shoqëria i nënshtrohet një sërë aktesh të tjera përfshi edhe mjedisore dhe sidomos ato që lidhen me mbrojtjen e mjedisit dhe mbetjeve, pasi pjesë e veprimtarisë së saj, tashmë prej vitesh është bërë funksional edhe landfilli i mbetjeve, e për pasojë, në këtë Zonë Industriale realizohen një sërë procesesh selektimi dhe teknologjike për disa kategori mbetjesh.

Në këtë kuadër, shoqëria trajton mbetje të ngurta dhe të lëngëta, mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, pa përjashtuar këtu edhe shërbime të tjera të menaxhimit të mbetjeve. Aktivitetin kjo shoqëri e realizon konform të gjitha rregullave dhe licencave ligjore të kërkuara nga legjislacioni në fuqi dhe të akorduara nga institucionet përkatëse shtetërore. Në këtë kuadër, kjo shoqëri është

pajisur me leje të tipit A, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Shoqëria "Brema Ambiente" Sh.p.k., disponon një kontratë me Shoqërinë "Gant Construction" Sh.p.k. për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të grumbulluara dhe transportuara nga Shoqëria "Gant Construction" sh.p.k., me qëllim diferencimin e kategorive të mbetjeve dhe trajtimin teknologjik të tyre referuar praktikave më të mira europiane të aplikuara.

LEJET DHE LICENSAT AKTIVE QË ZOTËRON SHOQËRIA "BREMA AMBIENTE" SHPK

Shoqëria është tashmë prej vitesh në aktivitet, e për pasojë zotëron një sërë lejesh dhe licensash dhe autorizimesh të vlefshme, për ushtrimin e veprimtarisë së saj, të lëshura nga disa institucione, si më poshtë vijon:

LEJA, LICENCA, AUTORIZIMI	NR. REF.	DATA E LËSHIMIT	PERIUDHA E VLEFSHMËRISË
Kontrate Koncesioni ne lidhje me Projektimin, Financimin, Ndertimin, Operimin, Mirembajtjen dhe Transferimin e "Parkut Industrial te Rrashbullit"	Nr. 3317 Rep Nr. 1305 Kol	17.10.2012	35 vjet
Kontrate Uzufukti per gezimin e siperfaqes Toke-Trull per ndertimin dhe operimin e "Parkut Industrial Rrashbull" ndermjet Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes dhe shoqerise koncesionare "BREMA AMBIENTE" Shpk	Nr. 7165 Rep Nr. 2190 Kol	17.06.2013	35 vjet
Leje ndertimi nga KKT per objektin "Ndertimi i Impiantit Industrial per perpunimin dhe menaxhimin e integruar te skrapeve metalike dhe ndertimin e landfillit perkates brenda territorit te Parkut Industrial"	Nr. 484/4	19.12.2016	36 muaj
Vendim i KKT për miratimin e shtyrjes se afatit te lejes se ndertimit per objektin	Nr. 16	28.02.2020	

"Ndertimi i Impiantit Industrial per perpunimin dhe menaxhimin e integruar te skrapeve metalike dhe ndertimin e Landfillit perkates brenda territorit te Parkut Industrial"			
Deklarate Mjedisore per projektin "Parku Industrial Rrashull dhe lendfilli perkates per mbetje industriale te llojeve te ndryshme"	AN140120210009 Vendimi 16	08.04.2021	
Licencë e kategorisë III.2.B	LN-3512-01-2022, Nr.1141 Prot, Nr. i Identifikimit te lejes 459, K.Nr 01	31.01.2022	Pa afat
Vendim per VNM Paraprake per projektin "Impiant për trajtimin e ujërave të ndotura teknologjike"	AN220920230006 Komisioni 135	27.12.2023	Pa afat
Leje Mjedisore Tipi A "Menaxhimi i Mbetjeve"	PN-0874-12-2021, Nr.1284 Prot, Nr. i Identifikimit te lejes 3806/6, K.Nr. 06	18.2.2025	Pa afat

Të gjitha Akt Miratimet e listuara, tashmë me një listë të gjatë kodesh mbetjesh dhe konkretisht leja mjedisore e tipit A, me numer PN-0874-12-2021 është dokumenti kryesor mbi bazë të të cilit funksionon aktiviteti i marrjes ne dorezim së mbetjeve nga Krijuesi i tyre. Gjithashtu, Shoqëria "Brema Ambiente" Sh.p.k. zotëron edhe certifikimet e nevojshme për cilësinë e shërbimeve të saj specifikisht për "Aktiviteti i mbledhjes, transportit, trajtimit, rikuperimit, riciklimit, asgjësimit e magazinimit të përkohshëm dhe përfundimtar, ngurtësimit dhe trajtimit të mbetjeve, të impianteve për sterilizimin e mbetjeve spitalore, në Shqipëri dhe jashtë saj, si dhe projektimi, realizimi dhe menaxhimi i veprave të përmirësimit dhe ripërtëritjes ambientale të terreneve dhe zonave të ndotura dhe landfillë", si më poshtë vijon:

Nr.	Certifikatë ISO	Certifikimi	Data Leshimit	Vlefshmëria
1.	9001:2015	Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë	28.08.2024	28.08.2027
2.	14001:2015	Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit	28.08.2024	28.08.2027

3.	45001:2018	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë	28.08.2024	28.08.2027
----	------------	--	------------	------------

Dokumentacioni paraqet kërkesën për ndryshim të kushteve të lejes për shtimin e disa kodeve të reja në leje dhe një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit fizik, biologjik dhe social në zonë, ndikimet kryesore në mjedis dhe ato sociale, përcakton masat e planifikuara për të parandaluar, minimizuar, zbutur dhe shmangur ndikimet e mundshme.

Subjekti po kryen njoftimin për dëgjuesën me publikun për ndryshimin e kushteve të lejes, sipas Vendim Nr. 419, datë 25.6.2014 dhe më pas do të kryejë të gjitha hapat për ndryshim të kushteve të lejes mjedisore, pas kryerjes së procedurës.

Sipas VKM Nr. 402 datë 30.06.2021 "Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve" kërkohen të shtohen në lejen ekzistuese mjedisore me numër: PN-0872-12-2021, disa kode të reja mbetjesh, si më poshtë:

➤ **Mbetje jo të rrezikshme**

KODI CER LLOJI I MBETJES

1. 01 03 09 Mbetje (në formë balte të kuqe) e dalë nga prodhimi i aluminit, të tjera nga ato të përmendura në 01 03 10
2. 01 05 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
3. 03 01 01 Mbetje të lëvores dhe të tapes
4. 03 03 01 Mbetje të lëvoreve dhe drurit
5. 03 03 08 Mbetje që dalin nga seleksionimi i letrave dhe kartonëve të destinuar për riciklim
6. 07 05 14 Mbetje të ngurta të tjera nga ato të përmendura në 07 05 13
7. 10 01 01 Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash (përfshijtur pluhurin e kaldajave të përmendur në 10 01 04)
8. 10 01 02 Hi fluturues
9. 10 01 03 Hi fluturues nga torfat dhe druri i patrajtuar
10. 10 01 15 Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash si rezultat i bashkëdjegies, të tjera nga ato të përmendura në 10 01 14
11. 10 01 19 Mbetje nga pastrimi i gazit, të tjera nga ato të përmendura në 10 01 05, 10 01 07 dhe 10 01 18
12. 10 08 04 Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur
13. 10 08 09 Zgjyra të tjera
14. 10 09 03 Zgjyrë furnalthe
15. 10 10 03 Zgjyrë furnalthe
16. 10 12 01 Mbetje nga përzierjet e përgatitura përpara përpunimit termik

- 17. 10 12 08 Mbetje qeramike, të tullave, tjegullave, pllakave dhe produkteve të ndërtimit (pas përpunimit termik)
- 18. 16 01 22 Përbërës të tjerë të paspecifikuar
- 19. 16 06 05 Bateri dhe akumulatorë të tjerë
- 20. 17 06 04 Materiale izolimi të tjera nga ato të përmendura në 17 06 01 dhe 17 06 03
- 21. 18 01 09 Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08
- 22. 18 02 06 Kimikate të tjera nga ato të përmendura në 18 02 05
- 23. 19 08 01 Ekzaminimet
- 24. 19 08 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara
- 25. 20 01 30 Detergjent të tjerë nga ato të përmendur në 20 01 29
- 26. 20 03 01 Mbetjet e përziera urbane
- 27. 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza

➤ **Mbetje të rrezikshme**

KODI CER

LLOJI I MBETJES

- 28. 01 04 07* Mbetje që përmbajnë substanca të rrezikshme që vijnë nga përpunimet fizik-kimike të mineraleve jometalore
- 29. 04 01 03* Mbetjet nga heqja e yndyrave që përmbajnë tretës pa fazë të lëngët
- 30. 05 01 11* Mbetjet që vijnë nga pastrimi i lëndëve djegëse me baza (alkale)
- 31. 05 01 12* Nafta që përmbajnë acide
- 32. 06 02 04* Hidroksidi i natriumit dhe kaliumit
- 33. 07 01 01* Lëngje ujore të larjes dhe lëngje meme ujore
- 34. 07 01 03* Tretës, lëngje larës dhe lëngje meme organike të halogjenuar
- 35. 07 01 04* Tretës, lëngje larës dhe lëngje meme organike të tjerë
- 36. 07 01 07* Mbetje të halogjenuara të distilimit dhe mbetje të halogjenuara të reaksioneve
- 37. 07 01 08* Mbetje të tjera të distilimit dhe mbetje të tjera të reaksioneve
- 38. 07 05 13* Mbetje të ngurta që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 39. 08 01 11* Mbetje të bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme
- 40. 08 03 19* Vajra disperse
- 41. 10 01 04* Hi fluturues naftë dhe pluhur kaldajash
- 42. 10 01 14* Hi nga fundi, skorje dhe pluhur kaldajash që përmbajnë substanca të rrezikshme si
- 43. 10 03 27* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohëse që përmbajnë vajra
- 44. 10 05 08* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohëse, që përmbajnë naftë
- 45. 10 06 09* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohëse, që përmbajnë vajra
- 46. 10 08 19* Mbetje nga trajtimet e ujërave ftohëse, që përmbajnë vajra
- 47. 11 01 07* Shëllira bazike për heqjen e skorieve
- 48. 12 01 09* Solucione dhe emulsione të makinerive që nuk përmbajnë halogjenë
- 49. 12 01 10* Vajrat sintetike të makinerive
- 50. 12 01 19* Vajra makine lehtësisht të biodegradueshëm
- 51. 12 03 01* Lëngje larës ujore
- 52. 13 03 01* Mbetje vajrash izolues dhe përcjellës nxehtësie që përmbajnë PCB

53. 13 03 06* Mbetje vajrash izolues dhe përcjellës të nxehtësisë të klorinuar me bazë minerale, të tjerë nga ato të përmendura në 13 03 01
54. 13 03 07* Vajra izoluese dhe përcjellës të paklorinuar me bazë minerale
55. 13 03 09* Vajra lehtësisht të biodegradueshme izoluese dhe përcjellës nxehtësie
56. 13 03 10* Vajra të tjera izoluese dhe përcjellëse nxehtësie
57. 13 04 01* Vajra të ndotura anijesh nga lundrimi pranë tokës
58. 13 04 02* Vajra nga ujëra të zeza të bankinave
59. 13 04 03* Vajra të ndotura nga lundrime të tjera
60. 13 05 03* Llumra ndërmjetëse
61. 13 05 07* Ujë me naftë nga seperatorët ujë/naftë
62. 13 07 02* Benzinë
63. 13 07 03* Lëndë të tjera djegëse përfshi edhe përzierjet
64. 13 08 01* Llumra nga shkripëzimet ose emulsionet
65. 13 08 02* Emulsione të tjerë
66. 13 08 99* Mbetje të tjera të paspecifikuara
67. 14 06 03* Tretës ose përzierje tretësish të tjerë
68. 15 01 11* Mbetje ambalazhi metalike që përmbajnë materiale poroze (p.sh. azbest), duke përfshirë kontejnerët bosh të presioneve
69. 16 01 21* Përbërës të rrezikshme, të tjera nga ato të përmendura në 16 01 07 deri 16 01 11 ,16 01 13 dhe 16 01 14
70. 16 05 06* Kimikate laboratorike që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme përfshirë përzierje të kimikateve laboratorike
71. 16 06 06* Elektrolite të ndara të mbledhur nga bateri dhe akumulatorë të tjerë
72. 16 10 01* Mbetje të lëngshme ujore, që kanë substanca të rrezikshme
73. 17 09 03* Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përzierja që përmbajnë substanca të rrezikshme
74. 18 01 06* Kimikate që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme
75. 18 02 05* Kimikate që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme
76. 19 02 05* Llumrat nga trajtimi fiziko-kimik që përmbajnë substanca të rrezikshme
77. 19 02 07* Vajra dhe koncentrate nga seperimi
78. 19 08 10* Graso dhe përzierje të tjera vajore nga seperatorët vaj/ujë, të tjera nga ato të përmendura në 19 08 09
79. 20 01 19* Pesticidet

Kodet e sipërcituara kërkohen për tu shtuar në listën e kodeve që posedon shoqëria pasi nga kërkesa e shoqërive gjeneruese që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, lind nevoja që shoqëria "Brema Ambiente" Shpk, nën cilësinë e pritësit të mbetjeve ti posedojë si kode për trajtim me qëllim plotësimin e detyrimeve ligjore. Sa i takon sasive për secilin kod mbetje, tek pjesa e menaxhimit për secilin kod është përmendur një sasi e përafërt mujore që mendohet të tërhiqet, pasi akoma nuk mund të kontraktujmë sasitë ekzakte të tyre, jo vetëm në kuadër të citimit të mësipërm, që do të duhet të licencohemi paraprakisht, por edhe për faktin se edhe gjeneruesit nuk mund të parashikojnë më saktësi, parakrisht prodhimin e tyre.

2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

Brema Ambiente Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në Parkun Industrial të Rrashbullit, e pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe kryen mirëmbajtje të kushteve të lejes sipas ligjit në fuqi. Territori ku shoqëria zhvillon aktivitetin e saj nuk cënon territoret e zonave të mbrojtura mjedisore, kurorës së gjelbër, hapësirës ujore rekreative, parkut urban, zonave të caktura për agroturizëm, kala, objekte fetare, rrënoja/arkeologji, ujëra sipërfaqësore etj. Ajo gjithashtu është larg zonave të banuara, shkollave dhe kopshteve.

KOORDINATAT E ZONËS SË PARKUT INDUSTRIAL DHE LENDFILLIT PËRKATËS SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGER		
Nr.	X	Y
1.	4378822.52	4575371.83
2.	4378793.68	4575299.34
3.	4378730.15	4575314.78
4.	4378619.97	4575292.94
5.	4378522.33	4575285.67
6.	4378510.18	4575252.02
7.	4378531.36	4575145.36
8.	4378533.41	4575080.22
9.	4379147.28	4575084.35
10.	4379108.32	4575105.8
11.	4379055.05	4575161.73
12.	4378964.57	4575212.09
13.	4378886.35	4575307.19
14.	4378870.72	4575347.98

KOORDINATAT E LENDFILLIT INDUSTRIAL SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGER		
Nr.	X	Y
1.	4378776.38	4575241.94
2.	4378794.43	4575229.13
3.	4378807.83	4575115.55
4.	4378786.62	4575097.59
5.	4378594.15	4575104.71

6.	4378573.54	4575128.31
7.	4378556.47	4575226.52
8.	4378578.37	4575243.07

EMËRTIMI I OPERACIONEVE PËRKATËSE	KOORDINATAT LENDFILLIT INDUSTRIAL SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUS KRUGER	
	X	Y
1. Impianti i trajtimit të ujërave të shiut	4378787.84	4575291.53
2. Peshorja	4378854.53	4575336.29
3. Gropa septike	4378812.11	4575331.58
4. Kapanoni i zyrave	4378835.36	4575356.79
5. Kapanoni i pushimit	4378843.72	4575353.34
6. Kapanoni i zhveshjes	4378851.26	4575350.73
7. Pus për nxjerrjen e lëngjeve	4378692.08	4575293.47
8. Vaska kundragazit	4378924.69	4575209.85
9. Impianti i djegies së gazrave biologjike me pishtar	4378907.22	4575176.16
10. Platforma e larjes së automjeteve	4378813.24	4575314.76
11. Serbatori i mbledhjes së ujërave të larjes së automjeteve	4378808.28	4575322.37
12. Kabina MT elektrike	4378873.54	4575322.18
13. Kapanoni i shërbimit të makinerive	4378822.01	4575347.14
14. Serbatori i gazolit	4378893.11	4575222.53
15. Serbatori i shpërndarjes së lëngjeve	4378877.63	4575215.71
16. Impianti i rikuperimit të metaleve	4378859.22	4575124.34
17. Kapanoni i impiantit të sharrave	4378887.82	4575273.29
18. Sheshi i magazinimit të metaleve ferrose dhe joferrose	4378824.15	4575204.84
19. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme	4378875.22	4575237.58
20. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme	4378868.09	4575250.55
21. Zona e magazinimit, cmontimit të mbetjeve nga motorrët e makinave	4378880.98	4575250.96
22. Lendfilli i Mbetjeve industriale të llojeve të ndryshme	4378692.34	4575164.63
23. Impianti i Trajtimit të ujërave të ndotura teknologjike	4378808.38	4575244.47

3. OBJEKTIVAT DHE QËLLIMI

Objektivi 1: Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative mjedisore

- Shkarkimet në ajër
- Shkarkimet në ujëra
- Shkarkimet në tokë
- Shkarkimet në kanalizime
- Zhurmat
- Ndikimi në florë/faunë
- Mbetjet e gjeneruara
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim në cilësinë e jetës në qendrat e banuara
- Ndikim në peizazhin e zonës

Objektivi 2: Gjetja e alternativave miqësore me mjedisin

-Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.

-Njohja me vlerën natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes ku do të zhvillohet aktiviteti.

-Njohja me infrastrukturën ekzistuese dhe nevojën për infrastrukturë të re për projektin.

Identifikimi i ndikimeve

Identifikimi i ndikimeve përcaktohet si ndërveprimi mjedis-projekt dhe identifikohen ndikimet e mundshme.

Vlerësimi i ndikimeve

Vlerësimi i ndikimeve ka të bëjë me vete rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përfaqëson atë me objektivisht më të mirë të bashkëveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorur për vlerësimin e rëndësise së ndikimeve variojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

Shtrirja fizike

Vlereson sipërfaqen apo dimensionin hapsinor të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që gjeneron atë ndikim.

Kohëzgjatja e ndikimit

Vlereson se sa do të zgjase një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i perkohshëm).

Kthyeshmëria

Vlereson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të mëparshme (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar).

Rëndësia

Realizon një vlerësim total të tre përmasave të mesipërme dhe njëkohësisht thekson vëmendjen që duhet patur për administrimin e ndikimit.

Qëllimi i këtij ndryshimi është pajisja me listën e re të kodeve në lejen mjedisore sipas kërkesave nga subjekte të ndryshme që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Qëllimi i shoqërisë është që të plotësojë të gjitha kushtet e operimit dhe gjithashtu për të vlerësuar ndikimet mjedisore të mundshme në elementet të tokës, ujë dhe ajër. Të gjitha proceset e punës që nga sigurimi i lendeve të para e deri në përfundim, do të zbatohen konform akteve ligjore në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij.

4. PROCESI TEKNOLOGJIK - PROCEDURAT PËR MARRJEN NË DORËZIM DHE PËR TRAJTIMIN E MBETJEVE

I gjithë procesi i trajtimit të mbetjeve nga shoqëria “Brema Ambiente” Shpk, kalon në një zinxhir të gjatë që fillon tek dera e strukturës koncesionare ku realizohet peshimi i mbetjeve që do të depozitohen në instalim dhe përfundon tek trajtimi fundor i tyre.

Në këtë proces, mbetjet pas marrjes në dorëzim, ndahen, ruhen, magazinohen dhe asgjësohen në mënyrë përfundimtare brenda Parkut Industrial dhe Landfillit, sipas llojit specifik të mbetjes. Gjithashtu bëhet klasifikimi sipas rrymave dhe industrive përkatëse që i gjenerojnë ato. Ato mbetje të cilat mund të rikuperohen, kalojnë për magazinim në stacionet përkatëse të transferimit për

mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet jo të rrezikshme, ndërsa mbetjet industriale të gjeneruara nga sektorë të ndryshëm dhe nga vetë linja e rikuperimit paraprak, të cilat nuk rikuperohen apo riciklohen i nënshtrohen operacioneve të landfillimit në qelizat përkatëse sipas procedurës së landfillimit.

Shoqeria perpara pranimit të mbetjeve në Parkun Industrial, kryen të gjitha procedurat e nevojshme të pranimit të tyre duke ndjekur rradhën e veprimeve si më poshtë vijon:

HAPI 1: Kontrolli i radioaktivitetit. Ngarkesat e mbetjeve në hyrje. Kontrolli radiometrik me aparat për të verifikuar praninë e ndotesve radioaktive.

HAPI 2: Kalimi i mjetit teknologjik në peshoren elektronike për peshimin e ngarkesës së mbetjeve që janë shkarkuar.

HAPI 3: Verifikimi i përputhshmërisë së mbetjeve me përshkrimin që është dhënë në dokumentacionin e dorëzuar nga gjeneruesi.

HAPI 4: Kontrolli i dokumentacionit shoqerues të mbetjeve.

Ky dokumentacion leshohet në 3 (tre) kopje për secilin pale Gjenerues – Transportues – Prites bazuar në llojin e mbetjes sipas referuar *Vendimit Nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"*; i ndryshuar dhe *Vendimit Nr. 371, DATË 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme"*; i ndryshuar.

HAPI 5: Trajtimi i mbetjeve sipas planit të menaxhimit referuar kategorise se tyre.

MJETET E NGARKIMIT DHE TRANSPORTIT TË MBETJEVE

Procesi i grumbullimit të mbetjeve realizohet nga staf i trajnuar dhe certifikuar, për ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e mbetjeve sipas objektit dhe kushteve teknike, si dhe ngarkimi në mjetet teknologjike të transportit do të kryhet në ambientet e gjeneruesit të mbetjeve dhe në varesi të llojit të mbetjes dhe paketimit të tyre, proceset e ngarkimit do të realizohen me anë të pajisjeve / mjeteve si më poshtë:

- *Me dorë;*
- *Me karrel levizes;*
- *Me pirun;*
- *Me eskavator;*

Apo cdo menyre tjeter e cila do te nevojitet per ngarkimin e mbetjeve specifike.

Sipas tipit te mbetjes, paketimit dhe tonazhit, percaktohet dhe menyra e ngarkimit te konteniereve dhe mjeteve teknologjike te transportit brenda Zones Industriale. Për këtë arsye Shoqeria "Brema Ambiente" Sh.p.k. ne perdorimin e saj ka mjete te cilat do te realizojne transportin e mbetjeve brenda strukturave.

Automjetet e përdorura për transport respektojnë te gjitha kushtet teknike te operimit si per mbetjet e rrezikshme dhe ato jo te rrezikshme.

- *Mjetet teknologjike të transportit përfshijnë një pjesë ngarkues-transportues, që rri e mbyllur dhe e siguruar, për të parandaluar hyrjen dhe ekspozimin e paautorizuar ndaj erës dhe reshjeve.*
- *Mjetet teknologjike të transportit janë projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos lejojë derdhjet; te mire izoluar nga rrjedhjet me stabilitet mekanik.*
- *Mjetet teknologjike të transportit i nënshtrohen larjes dhe dezinfektimit pas rrjedhjeve ose derdhjeve aksidentale.*
- *Mjetet teknologjike të transportit nuk përdoren në asnjë mënyrë për të transportuar ushqime, produkte ushqimore, konteniere ushqimore ose ndonjë substancë, e cila do të gëlltitet nga njerëzit ose kafshët ose do t'i shtohet ushqimeve të njerëzve ose kafshëve.*

Pershtatshmeria e mjeteve garantohet permes mirembajtjes te zakonshme dhe te jashtezakonshme, e cila realizohet ne menyre periodike per secilin mjet transporti qe do te perdoret. Te gjitha mjetet teknologjike te transportit ju nenshtrohen kontrolleve te detajuara perpara se te vihen ne perdorim per transportin e mbetjeve, jane te kolauduara, ne menyre qe te sigurohet mbrojtje maksimale e mjedisit dhe te parandalohet cdo ndotje e mundshme.

Cdo mjet teknologjik eshte i izoluar hermetikisht dhe merren masa per mbulimin e siperfaqes, per te siguruar qe nuk ka shperndarje ose pikim te mundshem te mbetjeve te ndryshme apo shperndarje te tymit pergjate transportit. Mbetjet jane ne cdo rast te mbrojtura nga agjentet atmosferike. Per realizimin e transportit te mbetjeve te rrezikshme subjekti transportues jashte Zones Industriale, ka vendosur ne dispozicion mjete qe:

- a) janë të përshtatshme për tipin dhe sasinë e mbetjeve që do te transportohen;*
- b) janë në përputhje me standardet rrugore;*

c) plotësojnë të gjitha kërkesat përkatëse të ADR-së (për mbetjet e rrezikshme) (jane te pajisura me certifikatat perkatese ADR – per transportin e mbetjeve te rrezikshme).

ç) janë regjistruar paraprakisht për këtë qëllim në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Mjeti teknologjike te transportit etiketohen ne menyre qe te identifikohet rreziku i mundshem i mbetjeve, ndihma e pare ne rast aksidenti ose rrjedhje, numer telefoni, emer kontakti. Pas shkarkimit ne ambjentet e Parkut Industrial, keto mjete ju nenshtrohen vazhdimisht proceseve te larjes ne oficina te jashtme ne instalim per te shmangur shperndarjen e cdo burimi ndotjeje te mundshme ne mjedis. Gjithashtu, vlen të theksohet se gjatë procesit të transportit të gjitha mjetet janë të mbyllura plotësisht. Pas ngarkimit, stafi merr masa për mbylljen e tyre me mbulesën përkatëse me qëllim evitimin e rrëzimit dhe përhapjes së tyre gjatë transportit, për pasojë edhe kontaminimin e akseve rrugore ku do kalojnë.

Procedurat e emergjences gjate transportit

Drejtuessi teknik dhe punonjesit e shoqerise jane te pajisur me njohuri rreth veprimeve qe duhen ndermarre ne rast rrjedhjesh ose aksidentesh dhe rregullat e kerkuara per paketimin e mbetjeve, etiketimin dhe transportimin jane ne zbatim te kodit kombetar dhe nderkombetar te transportit tokesor. Per cdo transferte te mbetjeve me qellim zbatimin e parimeve per mbrojtjen e mjedisit shoqeria grumbulluese dhe transportuese, do te plotesoje dokumentat e transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme sipas percaktimeve ne legjislacion:

- *VENDIM Nr. 371, datë 11.06.2014 PËR “PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DORËZIMIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME DHE MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË DORËZIMIT Të mbetjeVE TË rrezikshme”; i ndryshuar.*
- *VENDIM Nr. 229 date 23.04.2014 "PER MIRATIMIN E RREGULLAVE PER TRANSFERIMIN E MBETJEVE JO TE RREZIKSHME DHE INFORMACIONIT QE DUHET TE PERFSHIHET NE DOKUMENTIN E TRANSFERIMIT"; i ndryshuar.*

PROCESET E AKTIVITETIT NË PARKUN INDUSTRIAL

Pranë Prarkut Industrial, realizohen një sërë procedurash të trajtimit të mbetjeve. Më konkretisht më poshtë po listojmë një sërë veprimtarish me qëllim që të tregohen edhe veprimtaritë që lidhen

me lëndfillin e mbetjeve, pjesë e procesit të menaxhimit të mbetjeve nga Shoqëria "Brema Ambiente" sh.p.k. Në kuadër të lejit të aktivitetit të saj, Shoqëria "Brema Ambiente" Sh.p.k është e pajisur me leje mjedisore të tipit A, me numer PN-0874-12-2021. Gjithashtu, referuar Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit"; i ndryshuar, shoqëria operon lejen mjedisore përmes ID të mëposhtme:

MENAXHIMI I MBETJEVE		
Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e tipit A	Kapaciteti kufi për lejet e tipit B
ID 5.2 a. Lëndfill i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lëndfillin e mbetjeve inerte.	Kapaciteti i depozitimit është me i madh se 10 ton/dite ose kapaciteti i dizenuar i lëndfillit është me i madh se 25.000 ton.	
ID 5.2 b. Lëndfill i mbetjeve inerte.		Të gjitha instalimet
ID 5.3 e. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9).		Të gjitha instalimet
ID 5.4 b. Rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme me ane të operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10.		Të gjitha instalimet
ID 5.4 c. Rikuperimi i mbetjeve jo të rrezikshme.		Të gjitha instalimet
ID 5.5 Magazinimi i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
ID 5.8 Magazinim, rikuperim i hekurishteve/skrapeve të metalit ose cmontim i mbetjeve nga motorret e makinave.		Të gjitha instalimet
ID 5.10 a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Të gjitha instalimet
ID 5.10 b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
ID 6.2 Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen.		Të gjitha instalimet.

Kapaciteti i projektuar i Lendfillit të Mbetjeve Industriale është mbi **1.000.000 m³/mbetje** industriale të llojeve të ndryshme (L=222.43 m dhe B=130.53 m) me afat **35 vjet**; ose afersisht **115 ton/ditë**.

Specifikim teknik: Në operacionet e lendfillit të mbetjeve industriale përfshihen operacionet D1 dhe D5 (qeliza të vecanta të izoluar nga njëra dhe qeliza e madhe që izolohen qelizat e vecanta).

- Kapaciteti i projektuar për rikuperimin e mbetjeve të metaleve ferrose dhe jo ferrose është **120 ton/ditë**.
- Kapaciteti i projektuar magazinues i mbetjeve të metaleve ferrose dhe jo ferrose është **65 ton/ditë**.
- Kapaciteti i projektuar i stacionit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme është **30 ton/ditë**.
- Kapaciteti i projektuar i stacionit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme është **60 ton/ditë**.

• LANDFILLI I MBETJEVE INDUSTRIALE

Depozitimi dhe Inkapsulimi i Mbetjeve

Parimi i operacioneve që zhvillohen në landfillin e mbetjeve industriale të llojeve të ndryshme është vendosja në qeliza të veçanta, të renditura njëra pas tjetrës, të cilat mbulohen dhe izolohen nga njëra-tjetra dhe nga mjedisi etj, sipas operacionit D5 të Ligjit nr. 57/2025, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

SHTOJCA 1: OPERACIONET E ASGJËSIMIT

D1 Depozitimi nën dhe ose mbi dhe (p.sh. në lendfill etj.).

D5 Lendfilllet me projekte inxhinierike të posaçme (p.sh. vendosja në qeliza të veçanta, të renditura njëra pas tjetrës, të cilat mbulohen dhe izolohen nga njëra-tjetra dhe nga mjedisi etj.).

D14 Riambalazhimi para se t'i nënshtrohet cilitdo prej operacioneve të renditura nga D1 deri në D13.

D15 Ruajtja/magazinimi në pritje të cilitdo prej operacioneve të renditura nga D1 deri në D14 (me përjashtim të ruajtjes paraprake në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

- **MAGAZINIMI I MBETJEVE**

Magazinimi i mbetjeve realizohet ne ambiente te pershtatshme ne instalim (Kapanoni), konform te gjitha kushteve te ruajtjes per mbetjet e rrezikshme. Magazinimi sipas llojit te mbetjeve te percaktuara sipas Katalogut Shqiptar te Mbetjeve do te kryhet ne konteniere plastike, konteniere metalike, fuçi plastike apo metalike, depozita vertikale dhe horizontale, te pershtatshme dhe te ndara sipas kategorive te mbetjeve qe do te magazinohen ne ambientet e brendshme ose ne ambientet e jashtme te instalimit. Keto objekte magazinimi jane sipas te gjitha kushteve te pershtatshme per ruajtjen e mbetjeve, te izoluar plotesisht, te vendosura ne zona te pershtatshme te instalimit, duke respektuar te gjitha distancat nga siperfaqja e tokes, gjithashtu edhe nga njera tjetra. Objektet e magazinimit jane gjithashtu te pajisura me shenime dhe etiketat perkatese per secilin lloj mbetjesh, duke ju vendosur te gjitha shenimet dhe shenjat perkatese per llojin e mbetjeve te rrezikshme.

Brenda ambienteve te kapanonit ndodhen disa sektore:

- **Spektori i ndarjes manuale (separatimit)** ; (ndarja e materialeve per llojet e mbetjeve te rikuperueshme si: metale, plastike, pajisje elektrike dhe elektronike; bateri etj).
- **Spektori i magazinimit te mbetjeve te ngurta.**
- **Spektori i magazinimit te mbetjeve te lengeta.**

- **Rikuperim – Ekonomi qarkulluese**

Sipas Ligjit nr. 57/2025, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve".

SHTOJCA 2 "OPERACIONET E RIKUPERIMIT"

R 2 Rikuperimi/rikrijimi i solventëve/tretësve.

R 3 Riciklimi/përtëritja e substancave organike që nuk janë përdorur si solventë/tretës (përfshirë përzierje plehrash dhe të tjera procese te transformimit biologjik). Ky përfshin gazifikimin dhe pirolizën, që i përdorin këto përbërës si kimikate.

R 4 Riciklimi/ripërtëritja e metaleve dhe komponimeve të tyre.

R 7 Rikuperimi i përbërësve të përdorur për luftimin e ndotjes.

R 11 Përdorimi i mbetjeve të përfuara nga cilido nga operacionet e renditura nga R 1 deri në R 10.

R 12 Shkëmbimi i mbetjeve për t'iu nënshtruar cilitdo nga operacionet e renditura nga R 1 deri tek R 11. Në qoftë se nuk ka një kod tjetër të përshtatshëm R, ky mund të përfshijë operacionet paraprake para rikuperimit përfshirë para-përpunimin siç është, inter alia, çmontimi, grumbullimi

i diferencuar, thyerja/copëtimi, ngjeshja, peletizimi, tharja, grirja, zbutja, riambalazhimi, ndarja, bluarja apo përzierja para dorëzimit në cilindro nga operacionet e numëruara R1 deri R11.

R 13 Ruajtja e mbetjeve në pritje të cilitdo nga operacionet e renditura nga R1 deri në R 12 (me përjashtim të ruajtjes paraprake, në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

Parku Industrial përfshin kombinimin e disa teknologjive njëkohësisht, duke mundësuar rikuperimin e mbetjeve të ndryshme industriale si dhe diferencimin e mbetjeve të rikuperueshme që shërbejnë si lëndë e parë për industrinë e riciklimit.

- *Rikuperimi i mbetjeve ushqimore.*
- *Rikuperimi / Riciklimi i mbetjeve të ambalazheve.*
- *Rikuperimi i MPEE-ve (Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike) etj.*
- *Trajtimi i mbetjeve të lëngëta / solventëve në distilator.*

Mbetjet ruhen dhe magazinohen përkohësisht në objektin e stacionit të transferimit të mbetjeve dhe pasi është plotësuar sasia e nevojshme për transferim, dërgohen për riciklim apo asgjësim drejt operatorëve të licencuar që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- *Mbetje plastike; Mbetje qelqi; Mbetje letre e kartoni; Mbetje vaji etj.*

Shoqëria është duke punuar aktualisht për implementimin e një teknologjie për riciklimin e mbetjeve plastike.

I. STACIONI I TRANSFERIMIT TË MBETJEVE TË RREZIKSHME

Stacioni i transferimit të mbetjeve të rrezikshme shërben për ruajtjen/magazinimin e perkohshëm të mbetjeve të cilat do të nënshtrohen operacioneve të asgjësimit në lëndfillin industrial, apo do të dërgohen në operatorë të licencuar për trajtimin e metejshëm të tyre. Mbetjet të cilat do të ruhen/magazinohen në stacionin e transferimit të mbetjeve të rrezikshme ju nënshtrohen operacioneve të etiketimit/ambalazhimit dhe kodifikimit sipas legjislacionit në fuqi. Drejtuesi teknik i operacioneve është personi përgjegjës i cili do të menaxhojë të gjithë procesin e ruajtjes/magazinimit të perkohshëm të mbetjeve. Mbetjet e rrezikshme që ruhen/magazinohen perkohësisht janë të etiketuara/ambalazuara dhe të ndara nga njera tjetra, si dhe sheshi organizohet në mënyrë të tillë që të mundësojë levizjen e lirë të mjeteve të transportit dhe punonjësve.

II. STACIONI I TRANSFERIMIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME

Stacioni i transferimit për mbetje jo të rrezikshme shërben për magazinimin e mbetjeve të cilat fillimisht diferencohen sipas rrymave prioritare të tyre dhe pasi është krijuar një sasi e konsiderueshme, vlerësohet potenciali për riciklimin e tyre nga operatore të licensuar me qëllim reduktimin e mbetjeve që dërgohen në lëndëfillin industrial. Brenda stacionit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme, ruhen distancat e sigurisë, levizjes së mjeteve dhe levizjes së punonjësve. Mbetjet diferencohen në konteniere të posaçëm sipas kodeve perkatese të mbetjeve.

• TRAJTIMI I MBETJEVE TË LËNGËTA NË DISTILATOR

Mbetjet e lëngëta në trajtë solventi trajtohen në Distilator. Gjatë këtij procesi kryhet ndarja e pjesës së solventit nga pjesa e ujit. Solventët e ekstraktuar magazinohen dhe rifuten në ekonomi qarkulluese brenda ambjenteve të Parkut Industrial. Uji kalon për trajtim në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura teknologjike, sipas të gjitha fazave të skemës teknologjike të trajtimit.

• IMPIANTI I UJËRAVE TË NDOTURA TEKNOLOGJIKE

Impianti përdoret për trajtimin e ujërave të ndotura industriale që dalin nga aktiviteti që ushtron kompania "Brema Ambiente" Sh.p.k, leksiviatet që grumbulloara nga landfilli. Kjo teknologji në varesi të nevojës shërben gjithashtu për trajtimin e ujërave të ndotura nga industri të ndryshme përpunuese si:

-Industria e përpunimit të metaleve;

-Lengjet/mbetjet nga shpimet;

-Lengjet/mbetjet nga industria e bojërave;

-Lengjet/mbetjet nga supermarketet;

-Lengjet/mbetjet nga bulmetet etj.

Linja Teknologjike përmban:

- 1. Impianti i oksido-reduktimit**
- 2. Impianti neutralizues me kimikate**
- 3. Ultrafiltri**
- 4. Osmoza e kundert (RO)**
- 5. Osmoza e kundert (RO) disk-tubulare**

6. Evaporatori

